


RAPORTI JO-TEKNIK


HEC.EL-EN



Investitori: "V.B.NERGUTI"

PUNOI: STUDIO MJDISORE

ESDO



Contents

1	HYRJE	1
2	PERSHKRIM I SHKURTER I PROJEKTIT	2
2.1	Qellimi i projektit te propozuar	2
2.2	Planimetri e vendndodhjes së projektit, ku pasqyrohen në hartë topografike kufijtësipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUSS KRUGEr, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë:	3
2.2.1	Koordinatat e Nenobjekteve sipas sistemit koordinativ Gauss-Kryger.	4
2.2.2	Fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret ngaprojekti, gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit të veprimtarisë.....	4
2.2.3	Foto te Gjendjes Aktuale te zones ku do te ndertohen nenobjektet e HEC EL-EN Error! Bookmark not defined.	
2.2.4	Informacion për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti,shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit.	5
2.3	Pershkrim I Shkurter I Mbuleses Bimore	7
2.4	Pershkrimi i Faunes.....	8
3	Burimet Ujore	9
4	Identifikimi i Ndikimeve te mundshme ne mjedis	11
5	Përshkrim i shkurtër për shkarkimet dhe mbetjet e mundshme	15
6	Informacion për ndikimet dhe kohëzgjatjen e tyre në mjedis	16
7	Pershkrim i Shkurter per shkarkimet dhe mbetjet e mundshme	19
8	SHTRIRJA Hapsinore e ndikimeve ne mjedis	22
9	Mundësina e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar	23
9.1	PLANI I MASAVE TË NEVOJSHME PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE	23
10	NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR (NESE PROJEKTI KA NATYRE TE TILLE)	27
11	PERFUNDIME DHE REKOMANDIME	28
	Tabela 1Koordinatat e Veprave perberese te HEC-it	4
	Tabela 2 Ndikime Potenciale ne mjedis	17
	Figure 1Planvendosja e Objektit ne Harten topografike dhe Fizike te Shqiperise	3
	Figure 2Planvendosja e Nenvreprave te Hec-it ne Ortofoto.	4
	Figure 4 Planvendosja e Godines se Hec-it ne lidhje me qendrat e banuara afer tij	6
	Figure 5 Vendodhja e Fshatit Surroj.....	7

1 HYRJE

Nevoja për Energji Elektrike është një kërkesë e vazhdueshme jo vetëm për Shqipërinë, por edhe në rajon apo me gjerë. Shqipëria është deficiente në plotësimin e nevojave të vendit me energji elektrike dhe për këtë arsye, një ndër drejtimet kryesore të strategjisë për përmirësimin e sistemit të prodhimit, është edhe ndërtimi apo dhënia e të drejtës së shfrytëzimit me konçension e HEC-eve.

Projekti i propozuar është nga shoqëria "VB.NERGUTI " sh.p.k, me Nipt K 51716026 T .

Shoqëria ka përgatitur projektin, zbatimin e të cilit synon të shënojë një ndikim pozitiv në ekonominë lokale dhe të kontribuojë në drejtim të rritjes së prodhimit vendas të energjisë.

Nga ana tjetër, prodhimi i energjisë elektrike duke shfrytëzuar burimet ujore klasifikohet si përdorim i energjisë së natyrës apo burimeve të rinovueshme si uji, dhe qëndron në thelb të strategjive të prodhimit të energjisë në shkallë botërore që synon uljen e varësisë nga energjia fosile.

Në këtë kuadër, të zhvillimit të këtij projekti, është përgatitur Raporti i Thelluar i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM), i cili identifikon dhe analizon ndikimet e mundshme në mjedis nga ndërtimi dhe funksionimi i skemës hidroenergjetike të projektit të propozuar. Raporti, i cili është përgatitur nga studio mjedisore E.S.D.O , një kompani që zhvillon aktivitetin në fushën e konsulencës dhe ekspertizës mjedisore, jo vetëm vlerëson ndikimet fizike të drejtpërdrejta nga projekti, por edhe jep një pamje të përmbledhur të projektit si dhe legjislacionit dhe sistemit rregullator të mjedisit në Shqipëri.

2 PERSHKRIM I SHKURTER I PROJEKTIT

Shoqëria "VB.NERGUTI " Shpk, do të ushtroj veprimtarinë e saj të shfrytëzimit të rezervave ujore për prodhim të energjisë elektrike gjatë gjithë periudhës së marrjes me koncesion që do të investohen për rehabilitim të mjedisit të cilet do të sigurohen si grante psh. Koncesionet kanë të drejtë të disponojnë, të kryejnë transaksione me pale të treta dhe të shesë pjesë të energjisë elektrike të prodhuar nga ky hidrocentral duke përfshirë edhe transaksionet që ka të bëjë me prodhimin e energjisë së rinovueshme dhe vecanërisht në lidhje me Mekanizmat e Zhvillimit të Pastertise (Clean Development Mechanism) në kuadrin e Protokollit të Kyoto-s. Pjesa tjetër do të kontribuohet nga burimet financiare të vetë shoqërisë investitore, përfitim ky i mundësuar nga prodhimi dhe shitja e energjisë elektrike ndaj konsumatorit lokal.

2.1 Qellimi i projektit të propozuar

Objekti i këtij studimi është që të japë të dhënat klimatike dhe hidrologjike për projektimin e hidrocentralit në pellgun ujëmbledhës të përroit të Leshnices Dege e limit Drin, me derdhje në Liqenin e Fierzes.

Projekti i propozuar nga shoqëria "VB.NERGUTI " Sh.p.k synon shfrytëzimin e kapacitetit hidroenergjitik të përroit të Leshnices nepermjet ndertimit në pellgun e tij ujmbledhes nje hidrocentral te tipit me derivacion me fuqi te instaluar 1400 Kw

Prodhimi i energjisë elektrike duke shfrytëzuar burimet ujore si përdorim i energjisë së natyrës apo burimeve të rinovueshme, qëndron në thelb të strategjive të prodhimit të energjisë në shkallë botërore, që synon uljen e varesisë nga energjia fosile.

Shqipëria ka ende vështirësi në plotësimin e nevojave të vendit me energji elektrike.

Mbi 95% e prodhimit vendas sigurohet nga hidrocentralet ndërkohe që një pjesë e konsiderueshme e energjisë importohet . Kjo sasi në varesi të kushteve atmosferike vjetore varion ndërmjet 30% dhe 50% të totalit të furnizimit me energji primare .

Projekti është në linjë me politikën e Qeverisë Shqiptare që e ka konsideruar promovimin e përdorimit të energjive të rinovueshme, ku përfshihen edhe burimet hidrike, si një mënyrë të rëndësishme të politikave të energjisë për rritjen e sigurisë së furnizimit me energji, zhvillimin ekonomik, qëndrueshmërinë e sektorit të energjisë dhe mbrojtjen e mjedisit.

Në "Planin Kombëtar të Veprimit për Burimet e Energjisë së Rinovueshme në Shqipëri", parashikohet që për periudhën 2015-2020, të shtohet konsumi i burimeve të energjisë të rinovueshme në masën 38% e barabartë me 830 MW fuqi të instaluar, ku 750 MW nepermjet ndertimit të HEC-eve të vegjël.

Hidrocentrali do të ketë një fuqi të instaluar $N=1400$ kW dhe prodhim vjetor të energjisë prej 2.54 kwh/vit

Qellimi themelor i projektit është prodhimi i energjisë elektrike duke realizuar një vlerësim të përgjithshëm të integruar dhe në kohë të ndikimeve mjedisore të projektit me synim parandalimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis. Procesi i vlerësimit do të jetë i hapur dhe i administruar me paanshmeri, nepermjet pjesëmarrjes së plote të organeve qendrore e vendore ,organizatave jofitimpruresë për mjedisin, publikut, propozuesit të projektit dhe personave dizik e juridik , specialist të kesaj fushe.

Realizimi i ndertimit të hidrocentralit, përvet qëllimit kryesor të prodhimit të energjisë elektrike ,do të ndikojë pozitivisht dhe në përmirësimin e kushteve social-ekonomike të komunitetit të zonës. Zhvillimi i

ketyre aktiviteteve bazohet ne zhvillime te hershmedhe te reja te shfrytezimit te rrjetit hidroenergjitik te perroit te LESHNICES . Shoqeria investitore ka angazhuar grup specialistesh perkatesisht te gjeologjise, hidrogjeologjise, topografise, eko-ambientaliste dhe peisazheve ne te gjitha pellgun ujmbledhes te lugines , vecanerisht ne pjesen ku do te ndertohet HEC-EL-EN Ky aktivitet sipas llojit te projektit, qellimit dhe nderhyrjes se mjedisit klasifikohet si ndertimi i hidrocentraleve te vegjel lumor. Ai pervec qellimit kryesor te prodhimit te energjise elektrike do te sjelle impakte pozitive nepermjet:

- Ndertimit te objekteve te prodhimit te energjise elektrike me impakt negativ minimal ne mjedis
- Rritjen e punesimit dhe te specialisteve te fushes gjate fazes se ndertimit dhe shfrytezimit te vepres.

2.2 PLANIMETRI E VENDNDODHJES SË PROJEKTIT, KU PASQYROHEN NË HARTË TOPOGRAFIKE KUFIJTË SIPËRFAQES, TË SHOQËRUAR ME KOORDINATAT, SIPAS SISTEMIT KOORDINATIV GAUSS KRUGER, FOTOGRAFI DHE TË DHËNA PËR PËRDORIMIN EKZISTUES TË SIPËRFAQES QË DO TË PËRDORET PËRKOHËSISHT APO PËRHERË NGA PROJEKTI, GJATË FAZËS SË NDËRTIMIT APO FUNKSIONIMIT TË VEPRIMTARISË:

VENDODHJA E HEC EL-EN

Njesia Administrative : Kukes

Bashkia: Kukes

Perroi: LESHNICES




Figure 1 Planvendosja e Objektit ne Harten topografike dhe Fizike te Shqiperise




Figure 2 Planvendosja e Nenvëve te Hec-it ne Ortofoto.

2.2.1 Koordinatat e Nenobjekteve sipas sistemit koordinativ Gauss-Kryger.

Përshkrimi	Sistemi Koordinativ GAUS -KRUGER ZONE 4			Qmes (m3/s)	Qllog (m3/s)	Qekol (m3/s)
	E (m)	N(m)	Z(m m.n.d)			
Vepre e Marrjes, Përroi i Leshnices	4445165.01	4652661.43	+535	0.554	2.1	0.07
Baseni i Presionit	4446175.26	4656439.64	+521		2.1	0.07
Ndërtesa e Çentralit	4446092.19	4656400.01	+442		2.1	0.07

Tabela 1 Koordinatat e Veprave perberese te HEC-it

2.2.2 Fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret ngaprojekti, gjatë fazës së ndërtimit dhe funksionimit të veprimtarisë.

Sipërfaqja e Zonës që do të përdoret për zhvillimin e projektit aktualisht sot është e lirë nga objektet e tjera të gjithë nenobjektet e Hecit janë vendosur në afërsi të lumit të Leshnices. Te veprat e marrjes dhe gjithë nenobjektet e tjera nuk kemi zhvillime të objekteve të tjera dhe ndërtimi i tyre realizon marrjen e ujit duke kaluar në nenobjektet e tjera si dekantuesi, tubacioni Sifoni, baseni i presionit, tubacioni i turbinave dhe të gjithë të pozicionuar në anën e djathtë të lumit.

2.2.3 Informacion për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit.

Hidrocentrali EL-EN përbehet nga një veper marje me kuote të marrjes së ujit +535 m mbi nivelin e detit. Kjo veper do të shërbejë për kapjen e ujit nga perroi i Leshniçes do të marrë një prurje llogaritese 2.1 m³/s. Për të mos dëmtuar ekosistemin i cili përdor ujin nga ky perroi nga vepra e marrjes do të leshohet prurja ekologjike $Q_{ekol}=0.07\text{m}^3/\text{sek}$. Ndërsa në rastet kur nevojitet ujë për bujqesinë do të meren dhe 0.07.

Mbas dekantimit të ujit që derivohet nga vepra e marrjes kjo sasi uji transportohet fillimisht me anë të një kanali drejtkëndor B/A të mbuluar me dimensione (bxh) 1.2 x 1 m me pas për të kaluar perroin përdoret një Duker i cili është tub celiku me $D_j=711.2\text{ mm}$ i cili me ujin në godinë të HEC-IT

Kjo sasi uji $Q=2.1\text{ m}^3/\text{s}$ transportohet për tek baseni i presionit nëpërmjet një kanali drejtkëndor B/A i mbuluar me dimensione (bxh) 1.2 x 1 m. Mbasi uji mberin tek baseni i presionit në nivelin normal +521 m mbi nivelin e detit ai dergohet tek turbina Francis e vendosur tek ndërtesa e centralit me kuote aksi +442 m me anë të tubacionit të presionit, tub celiku me $D_j=812.8\text{ mm}$.

Nga analiza energjike e bere për skemen e Hidrocentralit EL-EN me prurje llogaritese prurja $Q=2.1\text{ m}^3/\text{s}$. Rënia bruto është (79m) ndërsa rënia neto për prurjen llogaritese 78m dhe prodhimi i energjisë vjetore është $E=4.62$ milion kwh ndërsa fuqia e instaluar do të jetë 1.4 MW.

Pellgu Uji mbledhës i Lumi Leshniçes fillon nga kuota + 1400 m (Gurra e Surroit) zbrit drejt perrot të Leshniçes në lartësi +850m për rreth 2.65km me pjerresi 207m/km, nga kuota + 850 m zbrit drejt lartësi +650m për rreth 3.3km me pjerresi 60.6m/km, nga kuota + 650 m zbrit drejt lartësi +550m për rreth 2.3km me pjerresi 43.5m/km, nga kuota +550 m zbrit drejt lartësi +540m për rreth 0.8km me pjerresi 12.5m/km, nga kuota +540 m zbrit drejt lartësi +305m për rreth 10.5km me pjerresi 22.4m/km, me tutje drejt liqenit të Fierzes në lartësi +300 m.

Në ndërtimin gjeologjik të rajonit të lumit të Leshniçes, një përhapje të konsiderueshme kanë shkëmbinjte ofiolitike jurasike të perfaqësuar nga harcburgitet, gabrot „ gabronoritet, noritet, plagiogranitet e pjesërisht dioritet kuarcore si dhe shëmbinjte karbonatike të Kretakut.

Në shumicën e sipërfaqes së pellgut ujëmbledhës dalin shkëmbinjte magmatike të masivit ultrabazik të Kukësit, që perfaqësohen nga llojet ultrabazike.

Në nivelet me të ulëta të relievit, në bazen e erozionit të perrenjve, dallohen depozitimet deluviale-proluviale, të kuaternari, të perfaqësuar nga blloqe e popla pjesërisht të përpunuar të shkëmbinjve gabrote, dallohen edhe depozitimet eluviale e deluvione, kryesisht në zonat me pak të aksidentuara e në shpatet e qete të relievit.

Ndërtimi gjeologjik i zonës ku shtrihet pellgu ujëmbledhës perfaqësohet nga një larmi formacionesh e moshash gjeologjike, kjo edhe për vetë sipërfaqen e madhe të këtij pellgu. Në përgjithsi zona dominohet nga shtrirja e shkëmbinjve magmatike, me pastaj

prej depozitimeve karbonatike (në rrjedhën e sipërme e të mesme të lumit) dhe depozitimet e moshave gjeologjike të reja (në rrjedhën e poshteme të lumit).

Nisur nga rëndësia e studimit kompleks do të përshkruajmë në teresi ndërtimin gjeologjik dhe me tëj do të ndalemi në gjeologjinë inxhinierike të nënveprave për hidrocentralin.

Vetë Lumi i Leshniçes është dege e Lumit Drin. Lumi i Leshniçes derdhet në Lumin Drin sot në liqenin e Fierzes. Rajoni, ku përshihet zona në studim është pjesë e Zonës Mirdita dhe me saktë është pjesë qendrore e kësaj zone. Për se të kalojmë në gjeologjinë e rajonit po japim material përgjithësues nga Gjeologjia e Shqipërisë.

Kjo njesi perbehet bashkite Tropoje ,Has dhe Kukes.

Ashtu si i gjithe vendi dhe kjo zone eshte perfshire nga levizjet migratore te popullates pas viteve '90.Migrimi i popullsise brenda rajonit, por gjithashtu per ne Tirane dhe jashte vendit, ka rezultuar ne uljen e popullsise pothuajse ne te gjithe fshatrat.

Perreth Zona ka qendra te vogla te banujara te tipit fshat . Disa prej te cileve(me te afertit) jane permendur me poshte:




Figure 3 Planvendosja e Godines se Hec-it ne lidhje me qendrat e banuara afer tij

Qendra me e afert e banuar eshte Fshati Fushare. Ai ndodhet rreth 2.1 km larg Godines se Hec EL-EN. Ka edhe fshatra te tjere te cilet kane largesi jo shume te madhe nga Projekti: Fshati Mamez 3.1 km larg godines se Hec-it , Fshati Cinamak rreth 2.6 km larg , Kolsh 4.6 km ,Kalimash 5.7 km , Drinas 6.1 km Myc-Mamez 4.5 km, Aliaj 7.6 km, Kryemadh 7.5 km si dhe fshati me popullsine me te madhe ne ate Zone rreth 5.8 km larg godines se Hec-it Fshati Surroj(Emri I te cilit ka qene ne ndarjet Komunale qe ka existuar deri disa vite me pare.




Figure 4 Vendodhja e Fshatit Surroj

Qyteti me I afert me Godinen e Hec EL-EN eshte Qyteti I Kuksit me nje largesi rreth 7.5 km.

2.3 PERSHKRIM I SHKURTER I MBULESES BIMORE

Relievi i Kukësit mbizotërohet nga ai kodrinor dhe sidomos malor me shpatë që kanë pjerrësi të ndryshme. Relievi kodrinoro-malor në rrethinat e pellgut të Kukësit dhe në periferinë malore të vargut lindor dhe pllajës së Shishtavecit, pjerrësia e shpatëve vjen duke u rritur gradualisht nga 8 - 100 deri në pjerrësi maksimale 45°. Prandaj pjerrësia e shpatëve është një element i rëndësishëm që duhet vlerësuar mirë në të gjitha nderhyrjet në mjedis qoftë në infrastrukture e urbanistike dhe në planifikimin hapsinor të territorit. Për shkak të shtrirjes së territorit të qarkut dhe përberjes gjeologjike të shkëmbit amnor gjenden të 4 tipet kryesore të tokës për sa i përket shtrirjes vertikale si: toka të hinjta kafe, të kafejta, të murrne pyjore dhe livadhore malore. Tokat e kafenjta malore gjenden në lartësi 1 000 m mbi nivelin e detit të përhapura në Shishtavec, Lusnë, Kollovoz, Morinë, Borjë etj Tokat e hinjta kafe shtrihen thuajse në pjesën kodrinore 6000-8000m dhe pikërisht përreth pellgut të Kukësit dhe në shtretërit e luginës së Drinit të Zi dhe Drinit të Bardhë. Tokat e murrne pyjore gjenden në zonat e larta malore mbi 1000 m. Tokat livadhore malore shtrihen në sipërfaqe të shkeputura në të dy anët e lumenjve Drini i Zi dhe Drini i Bardhë si dhe deget e tyre. Përgjithësisht, të gjitha llojet e tokave dallohen për potencial biologjik të mirë në drejtim të bimesisë së kultivuar, të frutikuturës dhe nga ana tjetër për kapacitete mbrojtëse kullësore të konsiderueshme në lloje të bimesisë me interes shkencor, studimor dhe clothës. Rrethi i Kukësit është mjaft i pasur në bimesi si në lloje ashtu edhe në shtrirje. Në qarkun e Kukësit takohen teritore me mikroklima të ashpër malore, ku rriten dhe zhvillohen pyje fletore dhe halore. Si rrjedhojë, mbulesa bimore përbehet nga dy grupe kryesore, që dallohen mirë nga njëra-tjetra, Bimesia me mbizotërim të elementeve floristik që zhvillohen në zonat me lartësi si (Koritniku, Gjalica, Kolesjani, Zepa, Alpet, Pashtriku etj.) dhe bimesia e tipit mesdhetar, e cila me ndërprerje deperton nëpërmjet luginave lumore të Drinit të bashkuar deri në qytetin e Kukësit. Bimesia është e përhapur në kate, por kufiri i tyre është i vështirë të dallohet. Për shkak të karakterit malor të territorit bimesia shkallëzohet vertikalisht në breza të ndryshme. E fillon me brezin e shkurreve, vazhdon me atë të dushkut, ahut dhe përfundon me kullotat alpine. Për arsye të ndikimit të klimës lokale dhe formave të ndryshme të relievit në të njëjtin kat

verehen perzierje bimesh. Brezi I shkurreve perfshin nje siperfaqe prej 3160 ha. Ne Kukës dhe disa zona te uketa te Tropojës gjenden shkurre si bushi, frasheri I bardhe, cermedella, shkoza e zeze, lajthite etj.

Brezi i dushkut shtrihet ne lartesine 800-1200 m mbi nivelin e detit ku bejne pjese lloje te ndryshme panjash, frasheri i bardhe te cilat takohen ne kurrizet e shpatet e kodrave, ne rrezen e maleve etj. Brezi i ahut shtrihet ne lartesine 1500-1800 m mbi nivelin e detit kryesisht ne shpatet lindore dhe veriore te maleve. Ata formojne masive pyjore ne malin e Gjalices, Kallabakut, Kolesianit etj. Brenda pyjeve te ahut rriten edhe lloje te tjera druresh gjethegjere si shkoza e bardhe, panja e malit, panja si rrap, kurse nga druret halore takohet bredhi i bardhe, pisha e zeze dhe arneni. Brezi i ahut nuk formon nje brez te vetem e te panderprere, por eshte i nderprere nga haloret ne lartesine 1600-

800 m.

Brezi i kullotave alpine shtrihet mbi lartesine 2000-2400 m. Ato zone nje siperfaqe se bashku me livadhet prej 12410 ha. Kullotat shtrihen kryesisht ne malin e Koritnikut, Gjalices, Lumes, Shishtavecit, Kollovozit, Kolesianit dhe Pashtrikut.

2.4 PERSHKRIMI I FAUNES

Bota shtazore e qarkut te Kukës me gjithe demtimet, ka perfaqesuesit e vet ne te gjitha rrethet. Nga gjitaret grabitqare (karnivore) qe takohen ne keto rrethe jane: ujku, dhelpra, rreqebulli, macja e eger, kunadhja, zardafi, qelbesi, ariu, vjedulla etj. Nga gjitaret jograbitqare jane: baldosa, derri i eger, lepur, ketri, kaprolli, urithi, iriqi dhe me rralle dhia e eger. Nder shpendet grabitqare jane: sorrat, laraskat, kukumjacka, bufi, hutini, harabeli, gala, skifteri, fajkoi dhe shqiponja e malit. Midis shpendeve jograbitqare jane: pellumbi i eger, turtulli, gjeli i eger, shkurta, shapka dhe thelleza e malit. Nga kafshet e ujit takohet: lundra (vidra) e cilajeton sine toke ashtu edhe ne uje, rosa e eger, lloje te ndryshme peshqish, bajza, pulbardha dhe rralle lejleke, Gjuetia sot shihet si nje rider elementet kryesore qe nxit dhe favorizon turizmin malor dhe ate sportiv ne Qarkun e Kukës si dhe burim te ardhurash per sektorin e pyjeve dhe biznesin vendas ne pergjithesi.

3 BURIMET UJORE

Ujërat sipërfaqësorë

Sistemi i gjere hidrologjik i Shqiperise perfshin 11 lumenj kryesore me 152 dege dhe perrenj te medhenj. Lumenjte kryesor nga veriu ne jug jane:

- Lumi Drin me dy deget e tij: Drinin e Bardhe dhe Drinin e Zi;
- Lumi Mat me degen kryesore te tij: Lumin Fan;
- Lumi Ishem;
- Lumi Erzen;
- Lumi Shkumbin;
- Lumi Seman me dy deget e tij ne rrjedhen e siperme: Lumin Devoll dhe Lumin Osum;
- Lumi Vjosa dhe dy deget e tij kryesore : Lumi Drinos dhe Lumi Shushica;
- Lumi Bistrica.

Ne bregun e majte dhe te djathte te Perroit te Leshnices derdhen nje seri perrenjsh gjate qjithe sektorit te siperm e te mesern. E kunderta ndodh ne rrjedhen e poshtme te ketij lumi ku derdhen vetem disa perroska te parendesishme per nga ujeshmeria.

Perroi i Leshnices derdhet lumin Drin, i cili ka nje siperfaqe te pellgut ujembledhes prej 68 km². Vete Perroi i Leshnices ne aksin e vepres se marrjes eshte rreth 36 km².

Ushqimi kryesor i ketij lumi perbehet prej reshjeve ne forme shiu dhe debore dhe prej ujerave nentokesore qe dalin ne forme burimesh ne formacionet karbonatike ne rrjedhen e siperme, magmatike dhe ato te kuaternarit.

Regjimi malor i rrjedhjes, ku lartesia e pellgut eshte e madhe, kushtet e formimit jane mjaft te favorshme per faktin se ato dallohen pervec pjerresise te madhe te relievit por edhe te reshjeve me te shumta se ne sektoret e tiere, te cilat ne te shumten e rasteve bien ne forme debore.

Perroi i Leshnices karakterizohet ne pergjithsi nga nje rrjet i zhvilluar hidrografik,vecanerisht ne sektorin e siperm dhe te mesem.

Liqenet

Perroi i Leshnices por edhe shume Perrenj te tjere te cilet jane ne Zonen qe do te nderohet Vepra kane derdhje ne Liqenin e Fierzes i cili ka nje larges NGA Godina e Hec-it prej L=4 Km. ë. Thellësia e liqenit shkon disa metra,ai ka ujë të ftohtë dhe shumë të pastër

Ujrat Nentokor

Ne aspektin hidrogjeologjik kjo zone paraqet nje larmi kompleksesh ujembajtes ne varesi te formacioneve shkembore dhe nivelit te zhvillimit te carshmerise, zhvillimit te fenomenit te karstit, rudhosjeve, thyerjeve tektonike dhe kontakteve tektonike te formacioneve ujembajttese me ato me pak ujembajttese dhe siperfaqeve qe zene ato ne raport me njera tjetren brenda pellgut ujembledhes te Leshnices

Ne kete kompleks futen shkembinjte intrusive te Jurasikut, shkembinjte efuzive te Triasikut te poshtem dhe shkembinjte efuzivo-sedimentar. Keta shkembinj kane ngjashmeri nga ana hidrogjeologjike, jane ne pergjithesi kompakte, me carje te pakta qe nuk shkojne shume ne thellesi te shkembit, me perjashtim te rasteve kur keta shkembinj jane te shkaterruar nga tektonika. Ne qender te linjave tektonike shkembinjte jane shkaterruar fare jane miellezuar, ndersa drejt aneve te linjes, miellezimi pakesohet dhe kalohet ne

brekcie tektonike dhe shkembinj ultrabazike te care e serpentinizuar deri sa me ne fund shenjat e tektonikes zhduken fare dhe kemi vetem shkembinj ultrabazike kompakte me carje te vogla. Ne pergjithesi shkembinjte e ketij kompleksi kane rezerva te paketa ujerash nentokesore te cilat i harxhojne brenda nje kohe te shkurter dhe ne shumicen e rasteve japin burime te perkoheshme me debit te vogel. Burime me debit te madh ne kete kompleks takojme vetem ne zonat e prishjeve tektonike, kur keto prishje dalin ne ane te shpateve te perrenjve, pra ne prerjet erozionale te tyre dhe prurjet e ketyre burimeve nuk i kalojne 5 l/sek. Burime te kesaj natyre i takojme ne masivin ultrabazik mbi lartesine + 1300m .

Gjithashtu debit te madh kane dhe burimet e ketij kompleksi qe ushqehen me uje nepermjet rruges te largeta, linjash tektonike, nga mbulesat gelqerore te Kretakut qe ne disa raste jane vendosur mbi keta shkembinj me transgression.Zakonisht burimet e medhenj te ketij kompleksi nuk kane dalje ujerash te koncentruar ne nje pike te vetme por dalin ne forme grup burimesh lineare ose siperfaqesore ne prerjen erozionale ose ne shpatin e malit me pjerrresi te vogel ne nje siperfaqe 100 - 200 m² dhe me shume.Burime dalin edhe ne kontaktet e ketij kompleksi me shkembenj te papershkueshem te komplekseve te tjere me te cilet kontaktojne tektonikish.

4 IDENTIFIKIMI I NDIKIMEVE TE MUNDSHME NE MJEDIS

Identifikimi i ndikimeve të mundshme në mjedis është marrë në konsideratë dhe analizuar që në fazën e studimit për efektet që do të ketë zbatimi dhe funksionimi i projekti si më poshtë:

- Në fazën përgatitore/instalimeve/ndërtimit të veprave inxhinierike, etj;
- Në fazën e funksionimit të hidrocentralit dhe prodhimit të energjisë elektrike;

Për një analizë sa më objektive të ndikimeve të mundshme në mjedis, fillimisht janë përcaktuar të gjithë aktivitetet/operacionet, të cilat si pasojë e zhvillimit të ciklit të tyre mund të bëhen shkak për ndikime. Operacionet kryesore në fazën e ndërtimit të veprës, me ndikime të mundshme në mjedis janë:

1. Ndërtimi i veprave të marrjes;
2. Hapja e tuneleve;
3. Vendosja e tubacioneve të derivacionit nga tunelet te sallat e turbinave;
4. Ndërtimi i objektit/godinës së centralit;
5. Instalimi i pajisjeve elektromekanike;
6. Lidhja me sistemin elektro – energjetik;
7. Ndërtimi i infrastrukturës ndihmëse, rrugët e aksesit;

Aktiviteti	Biodiversitet (fauna & flora)	Tokë	Ujëra	Ajër	Zona të mbrojtura	Zona urbane & shëndetin e njeriut
Përgatitja e infrastrukturës së ndërtimit ku përfshihen rrugët e aksesit, dhe kantieri i ndërtimit.	<p>Shqetësim i mundshëm dhe largim nga zona e punimeve të llojeve të faunës (reptilë dhe amfibë).</p> <p>Dëmtim i mundshëm i foleve të faunës së tokës (krimbat etj.).</p> <p>Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e qarkullimit të makinerive.</p>	<p>Ndryshim i natyralitetit të sipërfaqes së terrenit ku do të hapet rruga e aksesit.</p> <p>Shqetësim i sipërfaqes së tokës nëpërmjet kompaktësimit, erozionit dhe ndryshimit të strukturës.</p> <p>Ndotje aksidentale me hidrokarbure dhe lubrifikante si pasojë e avarive të makinerive të gëmmimit.</p>	<p>Shtim i mundshëm i sedimenteve dhe llumrave nëlumë si pasojë e erozionit të trasesë (run off, në kohë me reshje të forta dhe për shkak të pjerrësisë së terrenit).</p> <p>Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikante si pasojë e avarive të makinerive.</p>	Shkarkimet standarte të gazeve, grimcave dhe pluhurit dhe zhurmës nga makineritë e ndërtimit dhe operacionet e transportit.	S'ka	S'ka
Ndërtimi i veprës së marrjes	<p>Dëmtim i mundshëm i habitatit të brigjeve të lumit në vendin ku do të ndërtohet vepra e marrjes.</p> <p>Shqetësim i mundshëm i faunës ujore dhe llojeve që frekuentojë habitatin e brigjeve/Largim i përkohshëm nga zona.</p>	Erozion i mundshëm i brigjeve në vendin ku do të ndërtohet vepra e marrjes.	<p>Shtim i mundshëm i sedimenteve dhe llumrave nëlumë si pasojë e erozionit të trasesë (run off, në kohë me reshje të forta dhe për shkak të pjerrësisë së terrenit).</p> <p>Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikante si pasojë e avarive të makinerive.</p>	Shkarkimet standarte të gazeve, grimcave dhe pluhurit dhe zhurmës nga makineritë e ndërtimit dhe operacionet e transportit.	S'ka	S'ka

Ndërtimi i dekantuesit dhe basenit të presionit.	<p>Shqetësim/dëmtim i mundshëm i vegjetacionit në sipërfaqen e ndërtimit.</p> <p>Shqetësim dhe largim i përkohshëm i llojeve të faunës që përdorin këtë habitat (zvarranikët, amfibët dhe shpendët).</p> <p>Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e qarkullimit të makinerive.</p>	<p>Ndryshim i natyralitetit të sipërfaqes së terrenit ku do të hapet rruga e aksesit.</p> <p>Shqetësim i sipërfaqes së tokës nëpërmjet kompaktësimit, erozionit dhe ndryshimit të strukturës.</p> <p>Ndotje aksidentale me hidrokarbure dhe lubrifikante si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.</p>	<p>Shtim i mundshëm i sedimenteve dhe llumrave nëlumë si pasojë e erozionit të trasesë (run off, në kohë me reshje të forta dhe për shkak të pjerrësisë së terrenit).</p> <p>Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikante si pasojë e avarive të makinerive.</p>	Shkarkimet standarte te gazeve, grimcave dhe pluhurit dhe zhumës nga makineritë e ndërtimit dhe operacionet e transportit.	S'ka	S'ka
Instalimi i tubacionit të presionit	Shqetësim i habitatit dhe bimësisë natyrore në sipërfaqen e trasesë së derivacionit	<p>Tubacioni me presion do të vendoset në sipërfaqe, kështu që nuk shoqërohet me tjetërsim sipërfaqeje.</p> <p>Erozion dhe dëmtim i strukturës së tokës në sipërfaqen e trasesë së tubacionit.</p> <p>Shqetësim i sipërfaqes së tokës nëpërmjet kompaktësimit, erozionit dhe ndryshimit të strukturës.</p> <p>Ndotje aksidentale me hidrokarbure dhe lubrifikante si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.</p>	S'ka	Shkarkimet standarte te gazeve, grimcave dhe pluhurit dhe zhumës nga makineritë e ndërtimit dhe operacionet e transportit.	S'ka	S'ka
Ndërtimi i godinës së centralit	<p>Pastrim/dëmtim vegjetacioni në një sipërfaqen ku do të ndërtohet godina e centralit.</p> <p>Shqetësim i mundshëm dhe largim nga zona e punimeve të llojeve të faunës (reptilë dhe amfibë).</p> <p>Dëmtim i mundshëm i foleve të faunës së tokës (krimbat etj.).</p>	<p>Ndryshim i natyralitetit të sipërfaqes së terrenit ku do të ndërtohet godina e centralit .</p> <p>Shqetësim i sipërfaqes së tokës nëpërmjet kompaktësimit, erozionit dhe ndryshimit të strukturës.</p> <p>Ndotje aksidentale me hidrokarbure dhe</p>	Shtim i mundshëm i sedimenteve dhe llumrave nëlumë si pasojë e erozionit të trasesë (run off, në kohë me reshje të forta dhe për shkak të pjerrësisë së terrenit).	Shkarkimet standarte te gazeve, grimcave dhe pluhurit dhe zhumës nga makineritë e ndërtimit dhe operacionet e transportit.	S'ka	S'ka

	Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e qarkullimit të makinerive.	lubrifikante si pasojë e avarive të makinerive të gëmimit.	Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikante si pasojë e avarive të makinerive.			
Instalimi i pajisjeve elektromekanike	S'ka	S'ka	S'ka	Shkarkimet standarte të gazeve, grimcave dhe pluhurit dhe zhurmës nga makineritë e transportit.		
Lidhja me sistemin elektro-energjetik	Ndikime minimale në vegjetacion	Erozion dhe dëmtim i strukturës së tokës në sipërfaqet e vendosjes së shtyllave. Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikante si pasojë e avarive të makinerive të gëmimit.	S'ka	Shkarkimet standarte të gazeve, grimcave dhe pluhurit dhe zhurmës nga makineritë e transportit dhe ndërtimit.	S'ka	Ska

5 PËRSHKRIM I SHKURTËR PËR SHKARKIMET DHE MBETJET E MUNDSHME

Shkarkime të mundshme do të konsiderohen ujrat e ndotura, pluhurat, zhurma, gazet, si dhe prodhimi i mbetjeve.

Ujërat e ndotura: Zonat e banuara gjenden në distanca 4 km nga zona e projektit. Zona është rurale dhe nuk ka rrjet kanalizim-ujësjellës në afërsi të vendeve ku do të kryhen punimet e zbatimit.

Të vetmet ujra të ndotura që do të prodhohen, do të jetë ato të formës së lokalizuar nga ambientet e personalizuara për nevojat e kantierit. Këto ujra do të depozitohen dhe do të trajtohen në depozitë të përkohshme (p.sh gropë septike), deri në transferimin përfundimtar të tyre. Kontraktori do të sigurohet që këto ujëra të mos kenë në asnjë mënyrë kontakt me pellgjet lumore, apo tokën.

Pluhurat: do të gjenerojnë minimalisht si efekt i transporteve të lëndës parë, gomat e automjeteve me dherra branda kantjerit, materialeve të ndërtimit, trafikut të automjeteve, gjurmëve të konsiderueshme, ndërtimi të godinave, etj.

Gazet: Shkarkimet e gazeve acide në atmosferë kanë një ndikim negativ mbi ekosistemet e ujërave të ëmbla, të cilat janë të ndjeshme ndaj aciditetit si edhe ndaj cilësisë dhe përbërjes kimike të tokës. Burimi kryesor i çlirimeve të substancave acide në mjedis janë emetimet e gazta, që përmbajnë dyoksid sulfuri SO₂, okside të azotit NO_x, CO₂ dhe CO. Këto gaze mund të krijohen gjatë djegies së karburantit nga makineritë e ndërtimit, por vlerësohet se niveli i çlirimeve do të jetë shumë i vogël, thuajse i papërfillshëm, duke marrë parasysh dhe faktin se teknologjia e makinerive dhe pajisjeve do të jetë e re.

Mbetjet: do të gjenerojnë nga mbeturinat e ndërtimit, mbeturinat e kampingut, mbetje drusore, mbetje organike, copëza betoni, mbetje nga mbushjet e trupit rrugës (asfalt, zhavore, rërë, gurë), copëra leckash, mbeturina letre, mbeturina plastike, copëra tubash.

Zhurmat: në zonën e studimit nuk ka ndonjë informacion në lidhje me nivelet e ndotjes së ambientit. Zhurma nuk është shqetësimi kryesor në zonë, e cila ndodhet 4 km nga zonat rurale. Bazuar në distancën e largët, rreth 4 km në vijë ajrore, llojit të makinerive që përdoren për punimet ndërtimore dhe projektionit kompiuterik të zhurmave rezultojnë këtu fshat kontributi i zhurmës arrin max deri në 90 dBA, pra brenda normave të lejuara. Megjithatë rekomandohet që nivelet e zhurmës duhet të monitorohen gjatë ndërtimit por edhe gjatë operimit.

6 INFORMACION PËR NDIKIMET DHE KOHËZGJATJEN E TYRE NË MJEDIS

- Kohëzgjatja e ndërtimit të veprës do të jetë 12 muaj nga data e marrje së lejes së ndërtimit.
- Projekti që do implementohet nuk është objekt koncensionit por një objekt me pronësi private.
- Sipërfaqja që do të preket do të rehabilitohet paralel me kohën dhe fazën e ndërtimit.

Ndonese ne VKM Nr. 1189, date 18.11.2009 "Per rregullat dhe procedurat per hartimin dhe zbatimin e programit kombetar te monitorimit te mjedisit" percaktohen qarte indikatorët mjedisorë qe duhet te monitorohen, ata duhet te pershtaten dhe t'i perkasin veprimtarise. Qellimi i monitorimit mjedisor per veprimtarine e HEC-EL-EN eshte qe te siguroje te dhena nepermjet te cilave te vleresohet nese zhvillimi i veprimtarise eshte ne perputhje me ligjet dhe standartet mjedisorë qe lidhen me te, si dhe per te vleresuar performancen mjedisorë te menaxhimit te saj ne kuader te permiresimit te vazhdueshem.

Monitorimi i mjedisit gjatë fazës së ndërtimit dhe operimit të projektit është një veprim kyç për të njohur performancën mjedisorë të projektit, efektivitetin e masave lehtësuese dhe menaxhuese dhe masave korrektuese që do të merren nëse do të jetë e nevojshme. Plani Monitorues do të vazhdojë si pjesë e Planit të Menaxhimit Mjedisor të projektit. Bazuar në llojin e projektit dhe ndikimeve, monitorimi instrumental nuk është i nevojshëm dhe më i rëndësishëm është gjykimi viziv dhe profesional mbi informacionin e mbledhur gjatë inspektimeve. Më poshtë jepet një plan monitorimi orientues për t'u ndjekur gjatë fazave të projektit. Një plan i posaçëm më i detajuar mund të hartohet bazuar në vlerësimet e vitit të parë të monitorimit.

Parametrat për monitorim	Matja (metoda, paisja)	Shpeshtësia e monitorimit
Faza e ndërtimit		
<ul style="list-style-type: none"> • Sipërfaqja e pastrimit nga bimësia • Erozion në rrugë • Aksidente të faunës së egër • Vëllimi dhe lloji i mbeturinave • Menaxhimi i mbeturinave • Derdhje të mundshme nga makineritë 	Vizuale Të regjistrohet Instrumentale në rast se nevojitet	Inspektim ditor
Faza e operimit		
<ul style="list-style-type: none"> • Vëllimi i shkarkimit të prurjes ekologjike (Q₃₅₅) • Implementimi i Q₃₅₅ • Gjendja e bimësisë në brigjet e lumit në segmentin e devijuar • Gjendja e faunës akuatike dhe asaj të lidhur ngushtësisht me ujin • Prezenca e specieve të faunës në segmentet e devijuar në brigjet e përrenjve 	Vizuale Vlerësim eksperti për habitatet	Periodik

Ndikime	Matriksi Mjedisor
Ndërtimi: punimet e betonit, gërmimeve, punime mur gabioni, etj.	Ajër, Ujë, Tokë, Flora, Fauna, Zhurma,
Pluhurat: do të gjenerojnë si efekt i transporteve të lëndës parë, materialeve të ndërtimit, nga trafikut i automjeteve, gërmimeve të konsiderueshme, ndërtimi të godinave, etj.	Ajër, Flora, Fauna
Ndikime në komunitet Distanca nga zonat e banuara është 4 km , ndikim negativ s' ka të zonës.	Socio-ekonomik Ndikim pozitiv punësimin dhe
Shkarkimet e mbetjeve ndërtimore: hedhja dhe/ apo shkarkimi mbetjeve ndërtimore në trupat ujorë të përrenjëve dhe lumenjv	Ujërat
Ndikimi mbi të ardhurat ekonomike: Ndikimi i këtij aktiviteti nërang lokal dhe rajonal do të jetë pozitive dhe me impakt të rëndësishem për komunitetin e zonës përreth.	Socio-ekonomik
Ndikimi vizual: Gjatë fazës së ndërtimit dhe montimit, dëmtime të përkohshme do të ndikojë negativisht në peizazh (psh, prania e grumbujve me dhe, inerte apo materiale të ndërtimit dhe në relievin e tokës direkt në terrenit e implementimit të projektit për çdo shesh).	Peisazhi
Zhurmat: zhurmat tipike që shkaktohen gjatë procesit të ndërtimit nuk mund të shmangen. Zhurmat janë normale per nje aktivitet ndërtimor, nga transporti, gërmimet e tokës ,etj.	Personelit të zbatimit
Ndikimi nga operimi dhe mirembajtja: gjatë operimit zhurmat me të rëndësishme do të shkaktohen nga hidro-turbinat në objektin e Hidrocentralit, këto zhurma nuk do të jenë problematike në ambjentet jashtë godinës.	Personelit të zbatimit
Ekologjia ujore: mund të ketë ndikime të pjesshme nëekologjinë mjedisore të rrjedhës së ujit e cila do të përdoret për prodhim energjie nga hidrocentralet.	Gjallesat ujore
Ndikim në zonat e mbrojtura: zona e propozuar e projektit nuk prek asnjë zonë të mbrojtur apo monument natyror.	Ska ndikim
Ndikim në trashëgiminë kulturore dhe arkeologjike: ngapunimet e ndërtimit të këtyre Hidrocentraleve nuk do të ndikohet asnjë objekt/monument i trashëgimisë kulturore.	Ska ndikim

Tabela 2 Ndikime Potenciale ne mjedis

7 PERSHKRIM I SHKURTER PER SHKARKIMET DHE MBETJET E MUNDSHME

Shkarkime të mundshme do të konsiderohen ujrat e ndotura, pluhurat, zhurma, gazet, si dhe prodhimi i mbetjeve.

Ujërat e ndotura: Zonat e banuara gjenden në distanca 4 km nga zona e projektit. Zona është rurale dhe nuk ka rrjet kanalizim-ujësjellës në afërsi të vendeve ku do të kryhen punimet e zbatimit. Të vetmet ujra të ndotura që do të prodhohen, do të jetë ato të formës së lokalizuar nga ambientet e personalizuara për nevojat e kantierit. Këto ujra do të depozitohen dhe do të trajtohen në depozitë të përkohshme (p.sh gropë septike), deri në transferimin përfundimtar të tyre. Kontraktori do të sigurohet që këto ujëra të mos kenë në asnjë mënyrë kontakt me pellgjet lumore, apo tokën.

Pluhurat: do të gjenerojnë minimalisht si efekt i transporteve të lendës parë, gomat e automjeteve me dherra branda kantjerit, materialeve të ndërtimit, trafikut të automjeteve, gjurmimeve të konsiderueshme, ndërtimi të godinave, etj.

Gazet: Shkarkimet e gazeve acide në atmosferë kanë një ndikim negativ mbi ekosistemet e ujërave të ëmbla, të cilat janë të ndjeshme ndaj aciditetit si edhe ndaj cilësisë dhe përbërjes kimike të tokës. Burimi kryesor i çlirimeve të substancave acide në mjedis janë emetimet e gazta, që përmbajnë dyoksid sulfuri SO₂, okside të azotit NO, CO. Këto gaze mund të krijohen gjatë djegies së karburantit nga makineritë e ndërtimit, por vlerësohet se niveli i çlirimeve do të jetë shumë i vogël, thuajse i papërfillshëm, duke marrë parasysh dhe faktin se teknologjia e makinerive dhe pajisjeve do të jetë e re.

Mbetjet: do të gjenerojnë nga mbeturinat e ndërtimit, mbeturinat e kampingut, mbetje drusore, mbetje organike, copëza betoni, mbetje nga mbushjet e trupit rrugës (asfalt, zhavore, rërë, gurë), copëra leckash, mbeturina letre, mbeturina plastike, copëra tubash.

Zhurmat: në zonën e studimit nuk ka ndonjë informacion në lidhje me nivelet e ndotjes së ambientit. Zhurma nuk është shqetësimi kryesor në zonë, e cila ndodhet 4 km nga zonat rurale. Bazuar në distancën e largët, rreth 4 km në vijë ajrore, llojit të makinerive që përdoren për punimet ndërtimore dhe projektionit kompiuterik të zhurmave rezulton se në këtë fshat kontributi i zhurmës arrin max deri në 90 dBA, pra brenda normave të lejuara. Megjithatë rekomandohet që nivelet e zhurmës duhet të monitorohen gjatë ndërtimit por edhe gjatë operimit.

Ndikimet e Veprimtarive	Kohëzgjatja
Zonat e ndërtimit të veprave: Vendet ku do të instalohen pajisjet e kantierëve janë përzgjedhur pa bimbësi të dendur, në mënyrë që të minimizohen ndikimet. Sheshet e përzgjedhura në përgjithësi janë të zhveshura dhe jo të mbuluara me bimbësi të lartë. Këto përbëjnë sipërfaqe të zëna nga shkurre apo barishte përta të përkjet godinave të centralit, ndërsa veprat e marrjes dhe kanalet e derivacionit shtrihen në një sipërfaqe pjesërisht të gjelbëruar, kryesisht me bimbësi shkurre.	Afatmesëm

<p>Pluhurat: mund të gjenerohen si pasojë e transporteve të lëndës parë, materialeve të ndërtimit, trafikut të automjeteve, gjermimeve të konsiderueshme, ndërtimi të godinave, etj.</p>	Afatshkurtër
<p>Ndikime në çështjet sociale dhe ekonomike: Ndikimet në mjedisin social-ekonomik vlerësohen të jenë shumë pozitive dhe të shtrira në kohë. Zhvillimi i projektit do të ofrojë punësim për banorët lokalë gjatë fazës ndërtimore dhe funksionale.</p>	Afatgjatë
<p>Gërmimet: proceset e gjermimeve mund të kenë ndikime në ajër si p.sh emetimi i pluhurave, gjenerim të zhurmave, ndikim në peizazhin e zonës, etj. Këto ndikime vlerësohen të jenë normale për një proces të tillë ndërtimor.</p>	Afatmesëm/ Afatgjatë
<p>Ndikimi mbi të ardhurat ekonomike dhe cilësinë e jetesës: ndikimi i këtij projekti në rang lokal dhe rajonal do të jetë pozitive dhe me impakt të rëndësishëm për komunitetin e zonës përreth. Cilësia e jetesës do të përmirësohet ndjeshëmduke rritur të ardhurat ekonomike dhe duke i dhënë mundëzonen për të zhvilluar turizmin malor.</p>	Afatgjatë
<p>Ndikimi vizual dhe peizazhi: Gjatë fazës së ndërtimit do të kemi ndikime të përkohshme në peisazh (psh, prania e grumbujve me dhe, inerte apo materiale të ndërtimit dhe gjermimet e tokës direkt në zonat e implementimit të projektit për çdo vepër. Ky ndikim do të jetë i përkohshëm.</p>	Afatmesëm
<p>Zhurmat: zhurmat tipike që shkatohen gjatë procesit të ndërtimit nuk mund të shmangen. Zhurmat janë normale deri në 90 DBA për një aktivitet ndërtimor, nga transporti, gjermimet e tokës, etj. Zhurmat nuk pritet të sjellin ndikime në komunitet pasi zonat e punës janë në distanca shumë të mëdha nga banesat apo shtëpitë e distancuara.</p>	Afatshkurtër
<p>Ndikimet nga operimi dhe mirëmbajtja: gjatë operimit dhe mirëmbajtjes ndikimi mbi punonjësit do të jetë minimal sepse çdo punonjës do të pajiset me mjete të posaçme mbrojtëse sipër shembull kufje për veshët në rastin e godinave të centraleve.</p>	Afatmesëm/ Afatgjatë
<p>Rrjeti elektrik: që do të përdoret do të jetë rrjeti i ri i transmetimit i cili do të shërbejë për transmetimin e energjisë së prodhuar në hidrocentral. Ndërtimi i këtij rrjeti elektrikmund të ndikojë në bimesinë e zonës, vetëm gjatë fazës së ndërtimit.</p>	Afatshkurtër / Afatmesëm
<p>Ndikimi në infrastrukturë: Ndër ndikimet më të rëndësishme pozitive të projektit do të jetë përmirësimi i infrastrukturës së zonës, ku do të ndërtohen dhe rehabilitohen mbi 41 km</p>	Afatgjatë

rrugë lokale. Ky ndikim do të jetë afatgjatë dhe shumë pozitiv për zhvillimin e zonës, si dhe shkurtimin e distancave kohore me qendrat urbane më të afërta.	
Basenet e Presionit: ndërtimi do kryhet me bazament me betontë armuar. Baxhot e baseneve do të pajisen me një hapjeqendrore për të mundësuar uljen e mjeteve si dhe montimin enjë zgarë metalike për të kapur mbetjet inerte.	Afatmesëm
Ndërtimi i Tubacioneve të Derivacionit: ndërtimi i tubacioneve të cilat do të përcjellin të gjithë sasinë e ujit nga lumi dhe përroi pranë në afërsi të basenit.	Afatmesëm / Afatgjat
Ndërtimi i Godinave të Centraleve: nga ana strukturale,parashikohet që të realizohet me beton të armuar të derdhur në vend.	Afatmesëm

8 SHTRIRJA HAPSINORE E NDIKIMEVE NE MJEDIS

Shtrirje të mundëshme hapsinore të ndikimit negativ në mjedis, nënkupton distancën fizike nga vendodhja e projektit dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të.

Pluhurat: potencialisht mund të përfshijnë një rreze rreth 10 m nga të dy krahët e zonës së punës, shkaktar kryesorë do të jenë proceset e gjermimit, punët operative, transportet e automjeteve, mbushjet e trupit të rrugës, ndërtimi godinave.

Ujrat: nuk do të kenë ndikime të konsiderueshme, përveç ujrave të ndotura të mgjeneruara nga ambjenti kantierit. Shtrirja e tyre do të behet e lokalizuar nëpërmjet tubove, dhe kanaleve të filtrimit deri në një depozitë apo kanal përfundimtar i ujrave të ndotura.

Truall/ Dherat: Gjermimet do të gjenerojnë dherra, të cilët do të riciklohen për në trupin e rrugës, apo punime të tjera. Distanca e tyre nga baseni, nga trupi i rrugës, etj është tepër e vogël, arrin 1- 10 m.

Mbetje betoni: Do të konsiderohet tepërcat e betonit, dhe do të lokalizohen në një zonë të përkoheshme deri në një ripërdorim, apo transport përfundimtar në depozita. Distanca e tyre nga zona zbatimit do të variojë në një shtrirje prej 1-7 m.

Zhurmat: Do të konsiderohen si ndikime negative emetimet akustike në afërsi të zonave të banuara

Vibrime: Shpimet, goditjet me cekic pneumatik për ankorime apo gërryerje të shkëmbit meme. Zona e veprim/ ndikimit do të ketë një rreze 1- 20 m.

9 MUNDËSINA E REHABILITIMIT TË MJEDISIT TË NDIKUAR

Parimet e Planit të Menaxhimit të Mjedisit dhe Masave Zbutese

Per menjanimin dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis të identifikuar në seksionin paraardhës, kompania do të hartojë dhe zbatojë me përpikëri një Plan të Menaxhimit të Mjedisit dhe masave zbutese i cili ka për qëllim parandalimin ose minimizimin e ndotjes dhe dëmtimit të mjedisit si dhe shëndetin e sigurinë në punë.

Plani i Menaxhimit të Mjedisit synon respektimin e standardeve mjedisore gjatë kryerjes së aktiviteteve ndërtuese të HEC-it dhe me pas shfrytëzimit të tij, në mënyrë të sigurt dhe efektive, me qëllim final mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit. Konkretisht, ai fokusohet në ndikimet e identifikuar në mjedis në fazat e ndërtimit dhe të shfrytëzimit të vepres, masat përkatëse menjajuese ose minimizuese dhe institucionet përgjegjëse.

9.1 PLANI I MASAVE TË NEVOJSHME PËR ZBUTJEN E NDIKIMEVE

Masat kryesore të propozuara adresojnë zgjidhje të mundshme dhe të përshtatshme për minimizimin e ndikimeve negative në mjedis të identifikuar gjatë VNM. Këto masa duhet të synojnë:

- Rehabilitimin e sipërfaqeve që do të përdoren dhe ndikohen nga veprimtaria ndërtimore.
- Minimizimin e dëmtimeve të biodiversitetit (vegjetacionit dhe habitatit).
- Sistemimin e masës inerte që do të dalë nga gërmimet; përdorimin e një pjese të tyre në mbushje (në ndërtimin e komponentëve të HEC).

- Kontrollin e erozionit.

- Lëshimin e prurjeve ekologjike dhe programimin e lëshimit përgjatë rrjedhës ekzistuese.

Zbatimi me korrektësi i këtyre masave do të bëhet i mundur nga përdorimi i teknikave të mëposhtme:

- Piketimi i saktë i sipërfaqes së ndërtimit dhe kufizimi i veprimtarisë vetëm brenda saj.
- Kontrolli i dherave të gjeneruara dhe sistemimi i tyre nëpërmjet kompaktësimit.
- Sistemimin e nevojshëm për drejtimin e ujrave të shiut me qëllim zvogëlimin e erozionit.
- Kontrolli i pluhurave nëpërmjet lagës së zonës së punës dhe mbulimit të makinerive gjatë transportit.

- Kontrolli teknik i mjeteve të punës për të parandaluar rrjedhjet e karburantit.

Plani i masave për zbutjen e ndikimeve negative dhe mbrojtjen e mjedisit

Operacioni në mjedis	Ndikimi identifikuar	Receptori mjedisor	Masat e propozuara për zbutjen dhe kontrollin e ndikimeve
Biodiversitet			
Përgatitja e infrastrukturës së ndërtimit ku përfshihen rrugët e aksesit dhe kantieri i ndërtimit	Heqje/dëmtim i vegjetacionit nga sipërfaqja që do të zërë rruga e aksesit	Bimësia	<ul style="list-style-type: none"> • Për të mbajtur ndikimin në kufijtë e projektuar, përpara fillimit të gërmimit dhe ndërtimit të trasesë përkatëse, duhet të kryhet punë rievuese dhe të piketohet saktë sipërfaqet e punimeve. • Përdorimi maksimal i rrugëve ekzistuese. • Sistemimi i dherave për përdorim në rehabilitimet biologjike të nevojshme. Nëse rruga do të shërbejë edhe në fazën e funksionimit të hidrocentralit, përjashtohet mundësia e rehabilitimit të sipërfaqes që do të tjetërsohet si pasojë e ndërtimit të saj. Për të kompensuar këtë sipërfaqe, subjekti do të pyllëzojë një sipërfaqe tjetër, për madhësinë dhe llojin e bimëve të së cilës do të bashkëpunohet me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor në bashki. Përcaktimet për kompensim do të bëhen nga kjo e fundit sipas procedurave të legjislatcionit pyjor për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve përkatëse. • Vleresime të metejshme të ndikimeve në sistemin ekologjik mund të duhet të rivlerësohen në përputhje me kërkesat e procedurave të VNM (për miratimin mjedisor) mbas miratimit të projektit të zbatimit kur mund të kerkohen dhe ndryshime në pjesën teknike të projektit.

	Dëmtim i mundshëm i foleve të faunës së tokës (krimbat etj.).	Fauna	<ul style="list-style-type: none"> Inspektimi para fillimit të operacioneve për të analizuar me kujdes sjelljet e botës së gjallë dhe për të përcaktuar momentet e ndërprerjes së aktivitetit në faza të caktuara të ciklit vjetor të zhvillimit të biodiversitetit, si p.sh. koha e riprodhimit. Mbyllja e rrugëve të përkohshme të kantjerit në përfundim të ndërtimit të veprës për të shmangur hyrjen e panevojshme të banorëve në zona të ndjeshme ekologjike. Vleresime të metejshme të ndikimeve në sistemin ekologjik mund dhe duhet të rivlerësohen në përputhje me kërkesat e procedurave të VNM (për miratimin mjedisor) mbas miratimit të projektit të zbatimit kur mund të kërkojnë dhe ndryshime në pjesën teknike të projektit.
	Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e qarkullimit të makinerive.		<ul style="list-style-type: none"> Gjatë operacioneve të transportit dhe ndërtimit të veprave të HEC mund të ndodhin aksidente të tilla si shtypja dhe vrasja e zvarranikëve dhe amfibëve në zonë. Për këtë do të instruktohen punëtorët dhe kontraktorët të tregojnë kujdesin e duhur dhe lëvizja e mjeteve të bëhet me shpejtësi të ulët me qëllim që terreni të shihet qartë dhe të krijohet mundësia e shmangies së përplasjes së kafshëve të egra. Vendosja e tabelave sinjalizuese do të konsiderohet nëse gjatë inspektimit në terren rezultojnë kalime të shpeshta të zvarranikëve apo amfibëve përgjatë zonës së projektit (përgjatë rrugëve etj).
	Shqetësim i mundshëm dhe largim nga zona e punimeve të llojeve të faunës (reptilë dhe amfibë).		<ul style="list-style-type: none"> Masa më e përshtatshme për të adresuar këtë ndikim vlerësohet minimizimi i kohës së operacioneve në terren dhe largimi sa më i shpejtë i mjeteve të rënda që gjenerojnë zhurmë dhe shqetësim për faunën e egër. Ideale do të ishte sikur në stinën e pranverës (muajt mars-qershor) të kufizoheshin operacionet më shqetësuese për faunën për t'i dhënë mundësinë e riprodhimit të saj në zonën e projektit.
Punimet përndërtimin e veprës së marrjes	Dëmtim i mundshëm i habitatit të brigjeve të lumit në vendin ku do të ndërtohet vepra e marrjes.	Bimësia	<ul style="list-style-type: none"> Inspektimi para fillimit të operacioneve për të analizuar me kujdes sjelljet e botës së gjallë dhe për të përcaktuar momentet e ndërprerjes së aktivitetit në faza të caktuara të ciklit vjetor të zhvillimit të biodiversitetit, si p.sh. koha e riprodhimit. Mbyllja e rrugëve të përkohshme të kantjerit në përfundim të ndërtimit të veprës për të shmangur hyrjen e panevojshme të banorëve në zona të ndjeshme ekologjike.
	Shqetësim i mundshëm i faunës ujore dhe llojeve që frekuentojë habitatin e brigjeve/Largim i përkohshëm nga zona.	Fauna	<ul style="list-style-type: none"> Masa më e përshtatshme për të adresuar këtë ndikim vlerësohet minimizimi i kohës së operacioneve në terren dhe largimi sa më i shpejtë i mjeteve të rënda që gjenerojnë zhurmë dhe shqetësim për faunën e egër. Ideale do të ishte sikur në stinën e pranverës (muajt mars-qershor) të kufizoheshin operacionet më shqetësuese për faunën për t'i dhënë mundësinë e riprodhimit të saj në zonën e projektit.
Ndërtim i dekantuesit, basenit të presionit, godinës së centralit	Heqje/dëmtim i vegjetacionit nga sipërfaqja e ndërtimit	Bimësia	<ul style="list-style-type: none"> Për të mbajtur ndikimin në kufijtë e projektuar, përpara fillimit të gërmimit dhe ndërtimit të trasesë përkatëse, duhet të kryhet punë rievuese dhe të piketohet saktë sipërfaqet e punimeve. Përdorimi maksimal i rrugëve ekzistuese. Sistemimi i dherave për përdorim në rehabilitimet biologjike të nevojshme. Nëse rruga do të shërbejë edhe në fazën e funksionimit të hidrocentralit, përjashtohet mundësia e rehabilitimit të sipërfaqes që do të tjetërsohet si pasojë e ndërtimit të saj. Për të kompensuar këtë sipërfaqe, subjekti do të pyllëzojë një sipërfaqe tjetër, për madhësinë dhe llojin e bimëve të së cilës do të bashkëpunohet me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor në bashki. Përcaktimet për kompensim do të bëhen nga kjo e fundit sipas procedurave të legjisllacionit pyjor për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve përkatëse.

	Dëmtim i mundshëm i foleve të faunës së tokës (krimbat etj.).	Fauna	<ul style="list-style-type: none"> Inspektimi para fillimit të operacioneve për të analizuar me kujdes sjelljet e botës së gjallë dhe për të përcaktuar momentet e ndërprerjes së aktivitetit në faza të caktuara të ciklit vjetor të zhvillimit të biodiversitetit, si p.sh. koha e riprodhimit. Mbyllja e rrugëve të përkohshme të kantjerit në përfundim të ndërtimit të veprës për të shmangur hyrjen e panevojshme të banorëve në zona të ndjeshme ekologjike.
	Aksidente të mundshme të zvarranikëve dhe amfibëve si pasojë e qarkullimit të makinerive.		<ul style="list-style-type: none"> Gjatë operacioneve të transportit dhe ndërtimit të veprave të HEC mund të ndodhin aksidente të tilla si shtypja dhe vrasja e zvarranikëve dhe amfibëve në zonë. Për këtë do të instruktohen punëtorët dhe kontraktorët të tregojnë kujdesin e duhur dhe lëvizja e mjeteve të bëhet me shpejtësi të ulët me qëllim që terreni të shihet qartë dhe të krijohet mundësia e shmangies së përplasjes së kafshëve të egra. Vendosja e tabelave sinjalizuese do të konsiderohet nëse gjatë inspektimit në terren rezultojnë kalime të shpeshta të zvarranikëve apo amfibëve përgjatë zonës së projektit (përgjatë rrugëve etj).
	Shqetësim i mundshëm dhe largim nga zona e punimeve të llojeve të faunës (reptilë dhe amfibë).	<ul style="list-style-type: none"> Masa më e përshtatshme për të adresuar këtë ndikim vlerësohet minimizimi i kohës së operacioneve në terren dhe largimi sa më i shpejtë i mjeteve të rënda që gjenerojnë zhurmë dhe shqetësim për faunën e egër. Ideale do të ishte sikur në stinën e pranverës (muajt mars-qershor) të kufizoheshin operacionet më shqetësuese për faunën për t'i dhënë mundësinë e riprodhimit të saj në zonën e projektit. 	
Lidhja me sistemin elektro-energjetik (linja)	Dëmtim minimal i vegjetacionit në zonen e vendosjes së shtyllave	Bimësia	<ul style="list-style-type: none"> Pershpejtim i punimeve të montimit të shtyllave Sistemim i dherave dhe mbetjeve inerte Rehabilitimi i sipërfaqeve dhe traseve të transportit të shtyllave
Tokë			
Përgatitja e infrastrukturës së ndërtimit ku përfshihen rrugët e aksesit, dhe kantieri i ndërtimit. Ndërtimi i komponentëve inxhinierikë (vepra marrje, dekantues, basen presioni, tubacion me presion dhe godina centrali)	Ndryshim i natyralitetit të sipërfaqes së terrenit ku do të hapet rruga e aksesit.		<ul style="list-style-type: none"> Për të mbajtur ndikimin në kufijtë e projektuar, përpara fillimit të gërmimit dhe ndërtimit të trasesë përkatëse, duhet të kryhet punë rievuese dhe të piketohet saktë sipërfaqet e punimeve. Përdorimi maksimal i rrugëve ekzistuese. Sistemimi i dherave për përdorim në rehabilitimet biologjike të nevojshme. Nëse rruga do të shërbejë edhe në fazën e funksionimit të hidrocentralit, përjashtohet mundësia e rehabilitimit të sipërfaqes që do të tjetërsohet si pasojë e ndërtimit të saj. Për të kompensuar këtë sipërfaqe, subjekti do të pyllëzojë një sipërfaqe tjetër, për madhësinë dhe llojin e bimëve të së cilës do të bashkëpunohet me Drejtorinë e Shërbimit Pyjor në bashki. Përcaktimet për kompensim do të bëhen nga kjo e fundit sipas procedurave të legjislativës pyjor për heqjen nga fondi pyjor të sipërfaqeve përkatëse.
	Shqetësim i sipërfaqes së tokës nëpërmjet kompaktësimit.		<ul style="list-style-type: none"> Lëvizja dhe parkimi i makinerive brenda zonave të caktuara. Makineritë që do të përdoren do të sillen në kantier vetëm në kohën e operacioneve. Shoqëria ka kantier të saj në afërsi të zonës së HEC kështu që vendqëndrimi i mjeteve është pranë këtij kantieri. Planifikimi paraprak i punës dhe realizim i operacioneve në kohë sa më të shkurtër. Kontrolli dhe testimi periodik i gjendjes teknike të makinerive
	Erozion dhe dëmtim i strukturës së tokës.		<ul style="list-style-type: none"> Gërmimi duhet të kryhet vetëm në sipërfaqet e projektuara. Gërmimi duhet të realizohet në mot të thatë. Sipërfaqet e gërmuara dhe me pjerrësi të mbi 20% duhet të mbulohet me fibra plastike në mot me reshje intensive dhe të zgjatura në kohë. Në kuotat e sipërme të zonës së gërmimeve duhet të hapen kanale për devijimin e ujërave të shiut nga sipërfaqet e gërmuara.

	Ndotje aksidentale me hidrokarbure dhe lubrifikante si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.	<ul style="list-style-type: none"> Mjetet e ndërtimit duhet të kontrollohen periodikisht për gjendjen teknike me qëllim që të shmangen avaritë me pasoja si rrjedhja e hidrokarbureve në tokë. Mjetet e pastrimit të tokës në rast të ndotjes me hidrokarbure duhet të jenë të pranishme në kantierin e punimeve. Në rast të ndotjes aksidentale të tokës, duhet të hiqet dhe i ndotur dhe të ruhet në kontenerë të izoluar për t'u trajtuar më pas në vendin dhe mënyrën e përshtatshme.
Ujëra		
Ndërtimi i komponentëve inxhinierikë (vepra marrje, dekantues, basen presioni, tubacion me presion dhe godina centrali)	Shtim i mundshëm i sedimenteve dhe llumrave në rrjedhat e përrrenjve si pasojë e punimeve (gërmime, erozion).	<ul style="list-style-type: none"> Përsheptim i punimeve në shtratin e përroit (evitimi i zgjatjes së paarsyeshme të punimeve, planifikim dhe kapacitete). Punimet duhet të bëhen në mot të thatë. Llumi i gërmimeve duhet të evitohet nga kontakti me rrjedhën e përroit. Dherat dhe llumrat duhet të sistemohen dhe të mos lejohet të rrëshqasin në rrjedhën e përroit.
	Ndotje me hidrokarbure dhe lubrifikantë si pasojë e avarive të makinerive të gërmimit.	<ul style="list-style-type: none"> Mjetet e ndërtimit duhet të kontrollohen periodikisht për gjendjen teknike me qëllim që të shmangen avaritë me pasoja si rrjedhja e hidrokarbureve në mjedis.
Ajër		
Të gjitha operacionet	Shkarkimet standarte të gazeve, grimcave të pluhurit dhe zhurmës nga makineritë e ndërtimit.	<ul style="list-style-type: none"> Mjetet duhet të jenë çertifikuar për gjendjen teknike nga SGS Albania. Kontroll dhe mirëmbajtje në gjendje të mirë teknike të mjeteve të punës. Përdorim i lëndëve djegëse cilësore për motorët. Transporti i materialeve të ndërtimit duhet të bëhet me kamionë me karroceri të mbuluar. Në zonat e banuara shpejtësia e automjeteve duhet të kufizohet në 30 km/orë. Duhet të evitohet përdorimi i borive nëpër zonat e banuara.

Masat për të zbutur ndikimet në mjedis gjatë fazës së funksionimit të HEC-eve

Operacioni	Receptori ndikuar	Masat e rekomanduara
Prodhimi i energjisë elektrike	Habitati i brigjeve të lumit dhe fauna akuatike në segmentin prej 4 km të devijimit të ujit nga Perroi i Qinamit	<p>Ky është një nga ndikimet kryesore të hidrocentraleve për zbutjen e të cilit rekomandohet që të respektohen mënyrat rregulluese të ujit për të ruajtur habitatin dhe speciet e rrjedhës së poshtme.</p> <p>Për zbutjen e këtij ndikimi është i nevojshëm lëshimi i Q ekologjike e cila është llogaritur referuar ligjit 111/2012 "Per menaxhimin e integruar te ujerave", neni 39, pika 2, sipas të cilit "Çdo përdorues i ujit është i detyruar që në rrjedhën natyrore të lejojë rrjedhjen minimale ekologjike, duke mos e përfshirë atë në sasinë e ujit që është i autorizuar të përdorë".</p> <p>Kjo masë është shumë e rëndësishme sidomos gjatë muajve të thatë. Për të zbatuar këtë masë do të përgatitet një program ditor/javor/mujor duke u bazuar në të dhënat e matjeve të prurjeve ekzistuese.</p> <p>Hartimi dhe zbatimi i një plani monitorimi për sjelljen e faunës ujore në zonën e ndikuar është një masë që nevojitet për menaxhimin mjedisor të projektit.</p>

10 NDIKIMET E MUNDSHME NE MJEDISIN NDERKUFITAR (NESE PROJEKTI KA NATYRE TE TILLE).

Konventa "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis ne kontekst nderkufitar (Konventa ESPOO)" ka per qellim vleresimin e ndikimit ne mjedis te projekteve qe zhvillohen kryesisht ne zona nderkufitare dhe qe mendohet qe mund te kene ndikim ne mjedisin e vendeve fqinje. Shqiperia eshte pale ne kete Konvente qe prej 4 Tetorit te vitit 1991. Kjo Konvente synon bashkepunimin midis shteteve per mbrojtjen e mjedisit nderkufitar nga projektet me ndikim ne mjedis nepermjet:

- Njoftimit paraprak te shtetit, mjedisi i te cilit mund te ndikohet nga nje projekt i caktuar. Njoftimi behet nga Shteti, i cili synon te zbatoje projektin ne territorin e tij, i cili e fton Shtetin qe mund te ndikohet te marre pjese ne procesin e vleresimit te ndikimit ne mjedis te projektit te propozuar, duke i dhene kohe te mjaftueshme dhe vene ne disponim raportin e vleresimit te ndikimit ne mjedis te projektit te propozuar;

- Duke e njoftuar Shtetin e ndikuar per vendimin perfundimtar per projektin dhe kushtet per mbrojtjen e mjedisit qe duhet te respektohen.

Gjthashtu nga Shqiperia jane ratifikuar edhe amendamentet e saj, vendimet II/14 dhe III/17, nepermjet Ligjit Nr. 9478, date 16.02.2006 "Per aderimin e Republikes se Shqiperise ne vendimet II/14 dhe III/17, Amendamentet e Konventes se ESPOO-s "Per vleresimin e ndikimit ne mjedis, ne kontekst nderkufitar".

Subjekt i kesaj konvente jane te gjitha projektet e listuara ne shtojcen I te kesaj Konvente, ose me sakte ne Amendamentin e dyte te kesaj Konvente, ku jane listuar te gjitha projektet qe i nenshtrohen kerkesave te kesaj konvente.

Projekti i propozuar nuk ben pjese ne piken 11 te kesaj liste "Diga te medha dhe rezervuaret" dhe duke qene se projekti i propozuar eshte teper i vogel, dhe mbi te gjitha nuk eshte parashikuar te shfrytezohen ujrat e nje burimi ujqor nderkufitar.

11 PERFUNDIME DHE REKOMANDIME.

Konsulenti konsideronë ndërtimin e HEC-ve si një mundësi zhvillimi për komunitetin që do të ndikojë në përmirësimin e aspekteve social ekonomike të zonës. Investimi është i rëndësishëm edhe për faktin se do të realizohet në një nga sektorët më të rëndësishëm të ekonomisë me efekte të ndjeshme jo vetëm zonale por edhe rajonale dhe më gjërë.

Vlen të theksohet se përfitimi i energjisë nga burimet e rinovueshme është sot dhe do të jetë në të ardhmen një nga shtyllat bazë për një zhvillim të qëndrueshëm afat gjatë. Studimi në vetvete arrin në konkluzionin se në bilancin e përgjithshëm ndikimet do të jenë afat shkurtëra, të lokalizuara dhe përgjithësisht të riparueshme, ndërsa përfitimet do të jenë afat gjatë dhe gjithpërfshirëse në kohë dhe në komunitet. Zbatimi me sukses i projektit duhet të marrë në konsideratë dhe sugjerimet e dhëna në këtë material të cilat synojnë, parandalimin, minimizimin dhe evitimin e dëmeve potenciale mjedisore gjatë periudhës së zbatimit të punimeve dhe funksionimit të objektit. Kjo kërkon që secili prej aktorëve pjesë e këtyre proceseve do të duhet të zbatojë me seriozitet detyrat dhe rregullat mjedisore dhe administrative, në bashkëpunim të ngushtë me aktorët e tjerë pjesë e proceseve të mësipërme. Një rëndësi të veçantë merr ndjekja në mënyrë rigorozë dhe permanente e procedurave kontrolluse dhe monitoruese të të gjitha proceseve, por sidomos gjatë periudhës së zbatimit të punimeve. Me këtë rast institucione të tilla si ARM dhe pushteti vendore do të duhet të bashkëpunojnë në vazhdimësi për monitorimin dhe zbatimin korrekt të detyrimeve të palës zbatuese dhe asaj përdoruese të objektit gjatë gjithë jetëgjatësisë së veprës.

Pergatiti :

STUDIO MJEDISORE

ESDO

Ekspert Mjedisi :

ENIS CANI

